



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DROPULL**

RELACION TEKNIK

**FURNIZIMI ME UJË NGA PUS SHPIMET I UJËSJELLËSIT
RAJONAL DROPULL I POSHTËM DHE RRJETI
SHPËRNDARËS I UJËSJELLËSIT TË FSHATRAVE GORANXI
DHE DERVICIAN**

BASHKIA DROPULL

PROJEKT ZBATIMI

JV SHOQERIA "ZENIT&CO" sh.p.k & "ZETAKONSULT" sh.p.k
RRUGA Myrteza Topi, Ndertesë 18 Hyrja 7 Ap .38 kodi postar 1017. N Bash 9.
E-mail: zetakonsultshpk@gmail.com
Tirane-Albania

Tirane 2020

Lista e Standarteve dhe rregullave te aplikuar

EN 124	Kapaket e pusetave ne zonat ku kalojne automjetet dhe kembesoret.
EN 805	Kerkesat e furnizimit me uje per sistemet dhe komponentet jashte godinave.
EN 12201	Tubat e polietilenit me desitet te larte dhe rakorderite per furnizimin me uje te pijshem.
DIN PAS 1075	Pipes and fittings for HDPE 100 RC pipes
E DIN 8074	Tubat me polietilen PE 63, PE 80, PE 100, PE-HD; dimensionet
E DIN 8075	Tubat me polietilen (PE) PE 63, PE 80, PE 100, PE-HD; Kerkesa te pergjithshme per cilesine, provat.
EN 1171:2002	Valvolat prej celiku dhe gize, rakorderite, fllanxhat, bashkimet
EN 558	Valvolat, valvolat e celikut, dimensionet e valvolave metalike perdorimi ne tubat me fllanxha
EN 1092	Fllanxhat dhe bashkimet e tyre
DIN EN ISO 6708	Diametri nominal
DIN EN 12201	Tubat e bere me polietilen (PE) per uje te pijshem.
EN 10220; EN 10240	Tubat prej celiku per uje te pijshem.
EN 10284	Sistemet e tubacioneve prej polietileni
ISO 559	Tuba celiku per uje dhe kanalizime
DIN 1211/1211 –E	Pusetat
DIN 16963	Bashkimet e tubave dhe elementet prej polietileni me densitet te larte (HDPE) linja tubacionesh me presion.
EN 805 A.27.3-A 27.5	Testimi i tubacioneve HDPE PE100 me presion
DIN 19630	Udhezime per ndertimin e linjes se ujesjellesit ; DVGW kodi I praktikes
DIN 4124	Ndertimi i gropave , kanaleve , pjerresive,gjeresive te hapesirave te punes.
DVGW W 400-1	Rregullat teknike per sistemin e shperndarjes se ujit.
DVGW W 400-2	Ndertimi dhe provat
ISOEN 4064	Klasa B Mates uji per uje te pijshem.
DIN 4149-1	Ndertimi ne zonat sizmike
EN13101 A 400	Shkalle te galvanizuara te veshura me plastike

HYRJE

Ky raport teknik pershkruan:

Hapjen e dy pusçpimeve ne afersi te fshatit Grapsh.

Ndertimin e dy stacioneve te pompave qe do te sherbeje per furnizimin e depos 200m³ ne afersi te fshatit Grapsh

Ndertimin e nje linje te re me tubacion çeliku D=250mm nga stacioni i pompave ne rezervuarin 200m³ ne afersi te fshatit Grapsh.

Ndërtimin e një depoje grumbulluese në afërsi të fshatit Grapsh, qe do te sherbej per permirsimin e furnizimit me uje te te gjitha depove ne Dropullin e Poshtem

Ndertimin e rrjetit te jashtem te furnizimit me uje te fshatit Dervician.Furnizimin me uje te tre depove te fshatit Dervician me tub çeliku Ø108x4mm te cilet lidhen ne tubin Ø159mm (ekzistues) qe vjen nga fshati Goranxi.

Ndertimin e nje linje te re me tubacion PE100 RC D=50mm, nga burimi i "Shkurtja Valeri" deri ne depon e fshatit Goranxi.

Ndertimin e nje rrjeti shperndares te ri per fshatin Goranxi me tubacione polietilene me desitet te larte PE100 RC me presion PN 10 bar, ndertimin e pusetave te matesave te ujit individuale, ne te cilen do te instalohen matesat per cdo abonent familjar dhe ndertimin e kolektoreve vertikal ne raste te veçanta. Vendorsjen e tubave PE100 PN10 100 DN 25 per lidhjet familjareve nga rrjeti shperndares deri te puseta e matesave (kufiri i prones se shtepise te secilit abonent).

1. OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

Ky projekt hartohet me porosi te Bashkise Dropull.

Kontrata per projektin inxhinerik te hollesishem ju dha:

“ZENIT&CO” sh.p.k & “ZETAKONSULT“ sh.p.k

Objektivat e projektit jane permbledhur si me poshte :

- Hapjen e dy pusçpimeve se bashku me stacionet e pompave ne fshatin Grapsh.
- Ndertimin e rrjetit te jashtem te furnizimit me uje te depos grumbulluese 200m³.
- Ndertimin e rrjetit te jashtem qe do te suportoj furnizimin me uje te te gjitha depove ne Dropullin e Poshtem.
- Ndertimin e rrjetit te jashtem te furnizimit me uje te fshatit Dervician.
- Ndertimin e nje rezervuari grumbullues b/a me kapacitet 200m³ ne afersi te fshatit Grapsh.
- Rrethimin e stacionit te pompimit dhe te rezervuarit 200 m³.
- Ndertimin e nje linje te re me tubacion PE100 RC Dj=50mm, nga burimi i "Shkurtja Valeri" deri ne depon e fshatit Goranxi.
- Ndertimin e nje rrjeti shperndares ne fshatin Goranxi. Tubacionet do te jene polietileni me densitet te larte PE100 RC, PN 10 bar .
- Ndertimin e pusetave individuale, ne te cilat do te instalohen matesat e ujit per cdo abonent familjar dhe ndertimin e kolektoreve vertikal ne raste te veçanta. Tubacionet e rrjetit familjar do te jene polietileni PE 100, DN 25 PN 10.
- Furnizimi i konsumatoreve me uje, do te jete ne perputhje me legjislacionin Shqiptar dhe me kriteret minimale te meposhteme:
- Furnizim me uje 24 ore me presion te mjaftueshem, cilesi te ujit ne perputhje me standartet Shqiptare dhe te Komunitetit European EU .
- Presioni i ujit te cdo abonent familjar do te jete jo me i vogel se 2 bar dhe jo me i madh se 6.0 bar.
- Projektimi i sistemit eshte bere i tille, qe te riparohet dhe te mirembahet me kosto punimesh minimale.
- Sistemi eshte projektuar per nje afat kohor prej 25 vjetesh.

2. KUSHTET E SHESHIT TE NDERTIMIT

2.1.Vendndodhja

Derviçan, Grapsh dhe Goranxi, Njesia Administrative Dropull i Poshtem Qarku Gjirokastrer. Shtrihet ne jug-jug lindje të qytetit të Gjirokastrës.

2.2. Klima

Njesia Administrative Dropull i Poshtem ashtu si e gjithë Shqipëria bën pjesë në brezin e klimës mesdhetare, dhe dallohet për tipare më të shprehura mesdhetare-kontinentale.

Këtu predominojnë masat ajrore kontinentale që vijnë nga pjesa qendrore e kontinentit European nëpërmjet gadishullit të Ballkanit.

Vera është relativisht e thatë. Sasia minimale mesatare – mujore e reshjeve vërehet gjatë muajve Korrik – Gusht dhe kanë vlera 26.5 dhe 32 mm, kurse sasia maksimale vërehet në muajt Nëntor – Dhjetor me vlerat respektive 90.5 dhe 112.7 mm.

Muajt më të nxehtë të vitit janë Korriku dhe Gushti. Temperatura maksimale mesatare e këtyre muajve për një periudhë 50 vjeçare janë respektivisht 21.2 dhe 21.5 °C, temperatura minimale e ajrit vërehet gjatë muajve Janar – Shkurt me vlerat respektive 1.11 °C dhe 2.26 °C.

Dimri në përgjithësi është i ftohtë, me lagështi dhe i paqëndrueshëm. Gjatë dimrit bie bore dhe fryjnë erëra të forta. Sasia e borës e rëne gjate kësaj periudhe ka qënë e konsiderueshme, kurse vitet e fundit kjo është pakësuar mjaft, lidhur kjo me sa duket me ngrohjen e përgjithshme të klimës në botë.

Thellësia e ngrirjes sezonale të tokës nuk i kalon 5 cm në fushë dhe 10 cm në male.

Sipas të dhënave të stacionit të Gjirokastrës vlera maksimale e avullimit i takon muajve Korrik dhe Gusht dhe arrin 6.5 mm. Në periudhën e Dimrit ajo zvogëlohet në 0.4 – 1mm. Muajt më me lagështi maksimale janë Nëntori, Dhjetori, Janari. Vlerat minimale të lagështisë vërehen në muajt Korrik - Gusht dhe arrin 53 – 55%.

Në periudhën e dimrit predominojnë erërat me drejtim Lindor dhe Jug – Lindor, ndësa në verë ai Jug – Perendimor.

Shpejtësia maksimale e erës ndonjëherë arrin deri në 16 m/sek, ndërsa minimalja 1.6 m/sek.

2.3.Topografia

Zona e projektit ne fshatin Goranxi ka një sipërfaqe prej rreth 25 ha. Ajo shtrihet ne intervalin e kuotave midis 320m dhe 205m. Ky ndryshim kuotash nga depo ne rrjetin shperndares per rregullimin e presioneve ne sejcilen linje detyron perdorimin e valvolave dhe saracineskave prej GIZE. Për zonën e projektit jane bere matje topografike me **GPS SOKKIA GRX2** (gabimi ne pozicion planimetrik $\pm 2-3\text{cm}$, gabimi ne kuote $\pm 2-3\text{cm}$) dhe ndertimi i terrenit digital DEM me pas ne te cilin do te bazohet modelimi i skemës me Software-in WaterCad version V8i (SELECT seria 6).

2.4.Ndërtimi gjeologjik dhe hidrologjik

Në ndërtimin gjeologjik të zonës marrin pjesë këto depozitime nga poshtë lart:

- 1) **Depozitimet Gelqerore (Cr₁, Cr₂, Pg₁, Pg₂)**
- 2) **Depozitimet e Eocenit të sipërm (Pg₂³)**
- 3) **Depozitimet e oligocenit të poshtëm (Pg₃¹)**
- 4) **Depozitimet e oligocenit të mesëm (Pg₃²)**
- 5) **Depozitimet e oligocenit të sipërm (Pg₃³)**
- 6) **Sistemi neogjenik (N)**
- 7) **Depozitimet e Kuaternarit (Q).**

1. Depozitimet Gelqerore (Cr₁, Cr₂, Pg₁, Pg₂)

Kretaku i Poshtëm- Cr₁

Këto depozitime dalin përgjatë strukturave antiklinale të malit të Gjerë. Në pjesën e poshtme ato përfaqësohen nga gëlqerore porcelanike shtresë holle e shtresë mesëm, me ndërthurje shtresash e thjerrëzash silicore. Mbi gëlqeroret porcelanike vijon pakua e gëlqeroreve argjilore që ndërthuren me rreshpe argjilore, mergelore dhe shtresa të holla silicore. Sasia e silicoreve shtohet në pjesën më të sipërme.

Kretaku i Sipërm- Cr₂

Depozitimet e Kretakut të Sipërm zënë sipërfaqe më të madhe krahasuar me depozitimet e përshkruara më lart. Pjesa e poshtme e Kretakut të sipërm përfaqësohet nga gëlqerore shtresore pelitomorfe, gëlqerore argjilore shtresëhollë deri pllakor me thjerrëza e konkrecione stralli e më rralle gëlqerore kristaline. Më sipër, vërehet një pako më gëlqerore pelitomorfe, ndërthurur me gëlqerore fosfatike pllakor e petëzore ngjyre hiri në kafe, shtresa fosfatike ngjyre kafe më të errët, si dhe stralle fosfatike e jo fosfatike. Niveli më i sipërm i prerjes kretake përfaqësohet nga gëlqerore ngjyre hiri shtresëtrashë e masive si dhe gëlqerore organogjeno-copëzore ndërthurur me shtresa të holla gëlqerorësh pelitomorfe të bardhe.

Paleoceni – Pg₁

Këto depozitime duken në formën e një rripi të ngushtë që formon edhe reliev pozitiv në sipërfaqe duke rrethuar strukturat antiklinale. Përfaqësohen nga gëlqerore shtresë trashë dhe gëlqerore organogjeno – copëzor masiv të ndërthurur me gëlqerore mikrokorrizor. Trashësia e këtyre depozitimeve arrin deri në 200m. Në prerje kalimi nga depozitimet Kretake në ato Paleogjenike tregon njëpasnjëshmërinë e vendosjes së shtresave.

Eoceni – Pg₂

Këto depozitime marrin pjesë në ndërtimin e krahëve dhe zhytjeve periklinale. Në pjesën e poshtme të prerjes përfaqësohen nga gëlqerore organogjeno – copëzor dhe gëlqerore kryesisht

mikritik pllakor me përmbajtje materiali argjilor e mergelor që rritet në mënyrë graduale deri në dysHEME të pakos mergelore kalimtare. Në pjesën e sipërme mbizotërojnë gëlqerorët shtresore e pllakore me ngjyra që ndryshojnë nga e bardha në gri e në ngjyrë krem dhe rozë.

2. Depozitimet e Eocenit të sipërm (Pg₂³)

Mbushin pothuajse të gjitha strukturat negative të rajonit. Këto depozitime fillojnë me pakon kalimtare gëlqeroro – argjilore mergelore dhe vazhdojnë me depozitimet flishore .

Depozitimet flishore përbëhen nga ndërthurje ritmike të ranorëve e argjilave , ranorëve e alevroliteve, ranorëve – argjilave dhe alevroliteve ku sipas rastit mbizotëron here njëri- here tjetri element. Midis depozitimve flishore takohen shtresa gëlqerorësh, mergelesh, ranorësh, argjilash dhe linza konglomeratesh të pangopur .

Trashësia e këtyre depozitimeve lëkundet nga 700 – 1500 deri 2700 m .

3. Depozitimet e oligocenit të poshtëm (Pg₃¹)

Përhapen në dy krahët e luginës së Drinosit. Në pjesën e poshtme të këtyre formacioneve predominojnë argjilat me kalime në alevrolite, me përmbajtje në formë ndërshtresash apo linzash ranoresh, kurse në pjesën e sipërme vazhdojnë depozitimet flishore të përbëra nga ndërthurja e ranoreve me argjila (me mbizoterimin e këtyre të fundit), që përmbajnë linza konglomeratesh të pangopur. Argjilat kanë ngjyrë hiri deri në hiri të gjelbër me predominim të materialit alevrolit dhe karbonatik. Ranorët takohen në formë ndërshtresash të holla, d.m.th, si komponent përbërës i flishit. Ato janë me ngjyrë hiri të çelët dhe kryesisht kokerr vogel.

Trashësia e këtyre depozitimeve arrin 1000-1100m.

4. Depozitimet e oligocenit të mesëm (Pg₃²)

Këto depozitime janë të përhapura pak në zonën në studim. Këto përbëhen nga pako ranoresh dhe argjilash si edhe nga ndërthurje ritmike të shtresave të sipërme.

Ranorët kanë ngjyrë hiri të hapur, hiri të gjelbërt, kokrrizë mesem dhe kokrrizë madh, shtresë trashë poliminerale kompakt, kurse në pjesët e sipërme ato kalojnë në alevrolite.

Argjilat kanë ngjyrë hiri të gjelbërt, janë të gëlqerizuar dhe shpesh përmbajnë sasi të ndryshme materiali alevrolitik.

Trashësija e oligocenit të mesëm arrin 500m.

5. Depozitimet e oligocenit të sipërm (Pg₃³)

Dalin në pjesën qendrore të sinklinalit të Drinosit dhe në veri perëndim të rajonit. Në përgjithësi ato përbëhen nga argjilat me ngjyrë hiri të errët, kryesisht shtresë hollë, që përmbajnë ndërshtresa ranoresh dhe alevrolitesh. Në këto depozitime takohen gjithashtu damare të parregullt kalciti. Trashësija e dukshme e këtyre depozitimeve arrin deri në 1500m.




Fig. Harta skematike gjeologjike e zones

6. Sistemi Neogjenik (N)

Depozitimet e Neogjenit takohën në sinklinalin e Bamatatit, Drinosit etj. Midis tyre dallojmë:

a- depozitimet e Akuitanianit (N_1^a)

Përfaqësohen nga argjila, argjila dhe alevrolite mjaft të gëlqerizuar, nga njëherë mergelore dhe shtresa të holla ranorësh. Në pjesët e sipërme takohen depozitime mergelore. Argjilat janë ngjyrë hiri në jeshile, masive dhe përmbajnë zaje gelqerorësh dhe shkëmbinjësh të tjerë.

Ranorët janë ngjyrë hiri, hiri të hapur dhe kafe të kuqe, kryesisht kokërr vogël dhe më rrallë takohen kokërr trashë. Pjesa e sipërme e Akuitanianit është qymyr mbajtëse. Trashësija e depozitimeve të Akuitanianit është 150-300 m.

b. Depozitimet e Burdigalianit (N_1^b)

Përhapen në sinklinalin e Drinosit dhe Bamatatit. Këto depozitime përbëhen nga mergele me ngjyrë hiri të erret deri në hiri të bardhë, me shkalle të ndryshme ranorizimi, shumë të ngjeshur, shtresë hollë, që edhe me ndërshtresa ranorësh me trashësi të ndryshme.

Ranorët janë kokërr vogël deri në kokërr madh, me çimentim material karbonatik dhe argjilo-karbonatik.

Në depozitimet e pakos ranoro-argjilore të Burdigalianit takohen disa ndërshtresa konglomeratesh me trashësi të ndryshme, që përbëhen nga copëza rrumbullakosura mire të gëlqerorëve, ranorëve, shkëmbinjve intruzive dhe metamorfike të çimentuar fort nga materiali argjiloro-karbonatik.

Trashësija e depozitimeve të Burdigalianit arrin në 450-600m.

7. Depozitimet e Kuaternarit (Q).

Ndërmjet këtyre dallohen depozitimet aluviale, deluviale, aluviale dhe deluvialo- aluviale.

a) depozitimet aluviale mbushin të gjitha luginat e vjetra e të sotme të lumenjëve Drinos, Kserias dhe përrenjve të thate dhe përfaqësohen nga zhavorre, zhure, konglomerate, rëra dhe suargjila.

Zhavorret, zhuret e konglomeratet përbëhen nga zaje me shkallë të ndryshme rrumbullakimi kryesisht gëlqerore, ranorë, strallorë, por edhe të shkëmbinjve magmatike të cilët ndeshen shpesh në terracat dhe shtretërit e lumenjëve.

Rërat takohen rralle në forme ndërshtresash ose linzash, kokrrizë ndryshëm dhe shpesh përmbajnë zaje dhe përzierje materiali argjilor.

Suargjilat me ngjyrë të gjelbër hiri, hiri në të murrme, hiri, takohen me përhapje të gjerë në luginën e Drinosit, kurse në vendet e tjera vihen re shumë pak.

Keto depozitime ne zonen e studimit kane trashesi 10-20 m.

C) Depozitimet deluviale janë të zhvilluara në faqet e kodrave e maleve dhe kanë përbërje të ndryshme në mvarhtësi direkte nga përberja litologjike e shkëmbenjëve rrënjësor. Rrëze kodrave, shpateve dhe kreshtave malore, depozitimet në fjalë përbëhen nga shkëmbenj dhe brekçet shpatore.

Eluvionet i takojmë pothuajse kudo mbi depozitimet terrigjene duke formuar mbulesa subargjilash dhe surërash me ngjyrë hiri të verdhe, e murrme deri në kafe, nganjëherë me përmbajtje e copa ranorësh dhe gëlqerorësh. Trashësija e tyre arrin deri 1m.

Tektonika

Rajoni në studim hyn në zonën Jonike. Zona Jonike ndërtohet nga një numër vargjesh antiklinale dhe sinklinale që kanë orientim VP e JL.

Antiklinalet kryesor janë Mali i Gjerë dhe Libohovës.

Ndërmjet vargut antiklinal të Libohovë-Lunxheri dhe Malit të Gjerë shtrihet sinklinal i Drinosit. Ky sinklinal është i mbushur kryesisht nga depozitimet e Kuaternarit, Neogjenit dhe më pak nga ato të Oligocenit.

Antiklinali kryesor është ai i Malit të Gjerë me rënie monoklinale, drejt verilindjes dhe në bërthamën e së cilës zbulohen gëlqerorë të Triasikut të sipërm dhe pastaj me radhë të Jurasikut (J₁, J₂, J₃). Kretakut (Cr₁, Cr₂) dhe në fund të Paleocen-Eocenit (Pg₁-Pg₂¹⁻²).

2.4.1 Kushte Hidrogeologjike dhe gjeologjike inxhinierike

Të bazuara në ndertimin gjeologjik të truallit të kesaj zonë veçohen këta dy kolektore apo shkëmbinje ujëmbajtës

1. Ujrat nëntokësore në shkëmbinjt kompakt :

Me përshkueshmeri dhe ujëmbajtje te larte;

-Ku klasifikohen depozitimet gelqerore te (Cr₁, Cr₂, Pg₁, Pg₂)

Me përshkueshmeri të vogël të ndryshushme, kemi klasifikuar:

-Kompleksi uJOR i depozitimeve flishojdale (Pg₂³-Pg₃¹⁻²)

-Kompleksi uJOR i depozitimeve të neogjenit N₁₋₂

2. Ujrat nëntokësore në shkëmbinjet poroze :

Me përshkueshmeri mesatare deri të larte, ku klasifikohen depozitimet aluviale.

1. Ujrat nëntokësore në shkëmbinjt kompakt :

- Me ujëmbajtje te larte;

Ne kete kompleks me ujëmbajtje të lartë kemi përfshirë depozitimet me përbërje litologjike si me poshte:


Depozitime të Paleocenit-Pg1- Litologjikisht perfaqesohen nga gelqerore turbiditike, masive te nderthurur me gelqerore pllakore mikritike e mikrosHPatike, me ngjyre te bardhe

Depozitime të Eocenit-Pg2- gëlqerorë turbitike me copa të dolomiteve dhe rudistëve që kalojnë në gëlqerorë biomikritike, biomikritike e mikritike, me permbajtje argjilash mergelore.

Depozitime të Kretakut të poshtëm-sipërm-Cr₂,Cr₁-gelqerore turbitike, organogjene dhe gelqerorë sparitik, shtrese mesem-masive me rudiste, gastropode.


Formacionet e ketij kompleksi me ujëmbajtje te larte perfaqesojne masivin karbonatik te malit te gjere. Ato gjenden ne pjesen perndimore te zones se studimit ne masivin e Malit te Gjere si dhe ne pjesen lindore te zones ton te studimi dhe shtrihen nga jugu ne malin e Saraqinishtes e deri ne veri ne Labove te madhe.

HARTA HIDROGJEOLGJIKE SKEMATIKE E ZONES SE STUDIMIT



2.4.2 Sizmiciteti

Zona e projektit, sipas hartës së zonimit sizmik të territorit të Shqipërisë, nuk është sizmik, por, duke marrë parasysh parregullsinë e strukturës litologjike gjeologjike, vlerësohet 7-8 sipas shkallës Rihter.



3. KUSHTET SOCIAL - EKONOMIKE DHE KUSHTET E AMBIENTIT

3.1. Popullsia

Fshati Goranxi

Sipas te dhena te marre nga autoritet vendore, numri i popullsisë per zonen ne studim eshte rreth 830 banore dhe rritja e popullsisë ne fshatin Goranxi eshte 2.5% ne vit. Gjate hartimit te projektit u verifikua numri i shtepive dhe familjeve dhe rezultoi se ne: Fshatin Goranxi ka 210 lidhje.

Tabela 3.1-1 Popullsia ne fshatin Goranxi

PARASHIKIMI I POPULLSISE			
Popullsia aktuale	No =	830	
Perqindja e rritjes	p =	2.50	%
Numri i viteve	n =	25	vite
Popullsia e pritur	$Nn = No (1+p)^n =$	1539	banor

3.2. Situata Social – Ekonomike

Sipas studimit te kryer gjate hartimit te projektit, numri total banoreve eshte 830 banore. Numri mesatar i anetareve te familjeve eshte 4 vete.

4. SKEMA E FURNIZIMIT ME UJE

4.1.Situata aktuale

4.1.1 Skema operacionale aktuale.

Fshati Goranxi, Njesia Administrative Dropull i Poshtem Qarku Gjirokaster. Ne kete fshat rrjeti shperndares i furnizimit me uje eshte i amortizuar. Hartimi dhe zbatimi i projektit per rrjetin shperndares do ti jap fund mungeses se ujit te pijshem per kete fshat.

4.1.2 Projekti

Uji qe furnizon fshatin Dervican dhe fshatin Goranxi do te merret nga burimi i Manxhifes dhe nga stacioni i pompave qe do te ndertohet ne Grapsh, fshati Goranxi do te marre uje edhe nga burimi i "Shkurtja Valeri".

Do te ndertohet rrjeti i jashtem per furnizimin e depos grumbulluese 200m³,

Do te ndertohet rrjeti i jashtem per suportin e furnizimit te te gjitha depove ne Dropullin e Poshtem.

Do te ndertohet rrjeti shperndares komplet i ri ne fshatin Goranxi. Tubacionet do te jene polietilene me desitet te larte, HDPE 100, Pn 10 bar.

Do te vendosen kasete me matesa individual, ne te cilat do te instalohen matesat per cdo abonent familjar.

Do te ndertohet rrjeti komplet i ri, per lidhjet e familiareve, nga puseta e matesave deri te kufiri i prones se shtepise te sejcilit abonent. Tubacionet e rrjetit familjar do te jene polietilene HDPE 100, Dn 25 Pn 10.

Furnizimi i konsumatoreve me uje, do te jete ne perputhje me legjislacionin Shqiptar dhe me kriteret minimale te meposhteme :

Furnizim me uje do te jete 24 ore me presion te mjaftueshem , cilesi te ujit ne perputhje me standartet Shqiptare dhe te Komunitetit European EU.

Presioni i ujit te cdo abonent familjar do te jete jo me i vogel se 2 bar dhe jo me i madh se 6 bar.

Sistemi eshte projektuar bazuar ne Standardin EN 805 "Kerkesat per sistemet dhe perberesit jashte godines".



Fig. Rrjeti shperndares

4.1.3 Kriteret e projektimit

Sistemi eshte projektuar bazuar ne Standardin EN 805 "Kerkesat per sistemet dhe perberesit jashte godines".

Thellesia e ngrirjes 0.4 m. Thellesia minimale e pjeses se siperme te tubit nga siperfaqja e tokes ne linjen kryesore te transmetimit do te jete 1 m.

Thellesia minimale e pjeses se siperme te tubit nga siperfaqja e tokes ne linjen shperndarese te transmetimit do te jete 0.8 m.

Ne linjat e shperndarjes uji leviz me renie te lire. Te gjitha valvolat dhe matesat e ujit do te instalohen ne puseta. Presioni manometrik ne rrjetin e shperndarjes do te jete jo me i vogel se 2 bar dhe jo me i madh se 6 bar.


Valvolat e shkarkimit do te instalohen ne linja ne pikat me kuote me te ulet.

Zgjidhja e depos eshte konceptuar drejtekendore si per nga ana ndertimore , e cila eshte me praktike, ashtu dhe per nga ana ekonomike.

Struktura e depos do te konceptohet me sistem tra-kollone beton-arme si dhe diafragma b/a me C30/37 dhe hekur armature çelik S-500 (Kufiri i rrjedhshmerise 500kg/cm, koeficient sigurie $\gamma_s=1.15$ dhe zgjatim relativ $\geq 12-18\%$) . Soleta eshte projektuar monolite $h=20$ cm. Zgjidhja e struktures se soletes eshte modeluar me trare te fshehte me (rripa) ne hapesire ne te dyja drejtimet e kollones kerpudhe e vendosur ne mes te hapesires se soletes .

Skema statike e llogaritjes se struktures parashikon te gjitha nyjet te inkastruara .

Llogaritjet e mureve te depove behen ne baze te te raportit gjatesi me gjeresi .Ne rastin konkrete (gjatesia e mureve brenda per brenda) raporti $L/B = 8/7 < 2$. Ne kete rast muret e rezervuarit do te llogariten si pllake e vazhdueshme me presion ne faqet e tyre qe varion nga 0 nga maja ne vlere maximale ne lartesine $H/4$.



Muret do te llogariten per rastet kur kemi presion te ujit ne faqet e brendshme te murit dhe presionin e dheut nga jashte rezervuarit .

Themelet

Themeli i depos eshte projektuar pllake me trashesi 30 cm me beton C 30/37 dhe armature çelik S-500.

Thellesia e zhytjes se pllakes se themelit (pa perfshire shtresen e betonit te varfer $t=10$ cm dhe ate te zhavorrit $t=15$ cm) do te jete minimalisht 2.0 m nga fundi tabanit te depos(kjo do te shikohet ne baze te sistemimt ne realitet). Mbi pllaken e themelit realizohen mure mbajtese b/a me trashesi $b=30$ cm te nevojshme per te perballuar presionin e ujit nga brenda objektit dhe presionin e dheut nga jashte faqeve te depos .Tabani i themelit do te perforcohet me nje shtrese betoni te varfer $t=15$ cm dhe shtrese zhavorri $t=20$ cm .

Kollonat

Kollona eshte e konceptuar si kollona me kapitel e cila eshte vendosur ne mes te hapesires se soletes se mbulimit me baze kapiteli .Kjo per arsye te nje mbshtetje me te mire te soletes .Kollona eshte e llogaritur me permasa 30x30 dhe kapitel ne pjesen e siperme. Betoni i perdorur eshte C30/37 dhe armature çelik S-500 .

Soletat

Zgjidhja e soletes eshte e konceptuar pa trare por eshte zgjedhur skema e armimit me rripa ,riipa mbi kollonen e mesit dhe rripa mbi hapesire e cila ne thelb mund te konsiderohen si trare te fshehur ne solete . Ne periferi te saj soleta mbeshtet ne muret beton arme . Soleta eshte projektuar me trashesi $H=20$ cm me beton C 30/37 dhe armature Çeliku S-500.

Muret b/a

Muret b/a jane konceptuar si pllaka te vazhdueshme nen efektin e presioneve te ujit nga brenda faqeve te murit dhe nga jashte mureve nga presioni i dheut . Qoshet e mureve , takimet e mureve me pllaken dhe takimet e mureve me soleten do te realizohen me kend .Muret do te realizohen me tarshesi $b=30$ cm, me beton C 30/37 dhe armature çeliku S-500.

Normativat e Referimit.

KODET DHE STANDARTET

Për projektimin e këtij objekti, janë përdorur kodet dhe standartet e mëposhtëme:

Kushtet teknike Shqipëtare – KTP:

Në aplikimin e Rregullave Teknike referohen dhe respektohen Standardet dhe Rregullat Teknike të Projektimit në fuqi në vendin tonë.

Kodet europiane (Eurokodet)

- EN 1990 – Eurokodi 0: Bazat e projektimit të konstruksioneve të ndërtimit.
- EN 1991 – Eurokodi 1: Veprimet mbi strukturat
- EN 1992 – Eurokodi 2: Projektimi i konstruksioneve betonarme
- EN 1996 – Eurokodi 6: Projektimi i ndërtesave me mure mbajtëse
- EN 1997 – Eurokodi 7: Projektimi gjeoteknik
- EN 1998 – Eurokodi 8: Projektimi i strukturave rezistente ndaj tërmeteve

Shënim:

Nisur nga periudha e gjatë kohore në të cilën janë formuluar standartet shqiptare, d.m.th. ato janë akoma të pa rinovuara, struktura do të llogaritet kryesisht referuar normave europiane EC, dhe vetëm ku do të jetë e nevojshme apo e domosdoshme do të përdoren standartet KTP

Standarde dhe Rregulla Teknike të referuara

Përveç referencave të përgjithshme, në kushtet teknike citohen, në vendet përkatëse, edhe këto referenca të tjera:

- ISO 1000: Njësitë e Sistemit Nderkombëtar (S.I.) dhe rekomandimet për përdorimin e shumëfishave, nëfishave të tyre, si dhe disa njësi të tjera;
- ISO 8930: Parimet e përgjithshme mbi sigurinë (besueshmërinë–riliabilitetin) e konstruksioneve – Lista e termave ekuivalente;
- EN 1090–1: Zbatimi i konstruksioneve metalike–Rregulla të përgjithshme dhe rregulla për ndërtesat;
- EN 10025: Produkte hekuri (çeliku) të paleguar (jo aliazh), të përpunuar në të nxehtë–Kushte teknike të dorezimit (furnizimit)
- EN 1337–1: Mbështetjet strukturore – Kërkesa të përgjithshme
- EN 1998–4: Parimet dhe rregullat e aplikimit për projektimin sizmik sillosave ,rezervuareve dhe tubacioneve

Njësitë matëse

Njësitë S.I. duhet të përdoren në përputhje me Rregullat Teknike në fuqi (sipas Standarteve ISO 1000). Për llogaritjet rekomandohet të përdoren njësitë që vijojnë:


- | | |
|--|--|
| — forcat dhe ngarkesat: | kN, kN/m, kN/m ² ; |
| — masat njësores (densitetet)dhe masat | kg/m ³ , t/m ³ kg, t |
| — peshat njësores (peshat specifike): | kN/m ³ ; |
| — nderjet dhe rezistencat: | N/mm ² (= MN/m ² ose MPa), kN/m ² (=kPa); |
| — momentet (përkulje etj): | kN |
| — shpejtimet (akseleracionet): | m/s ² , g (= 9,81 m/s ²). |

Vetitë fiziko-mekanike të materialeve

Materialet që do të përdoren për projektimin e strukturës (betoni dhe çeliku) duhet të plotësojnë të gjitha kriteret e parashikuara në Eurokodin 2 si dhe në Eurokodin 8.

Çeliku

Çeliku që do të përdoret duhet të gëzojë veti të mira si në rezistencë ashtu edhe në deformueshmëri (duktilitet). Në elementët parësorë sizmike, për armaturën e hekurit duhet të përdoret çelik i klasës B ose C, sipas tabelës C1 në Aneksin Normativ C të Eurokodit 2, EN 1992. Më poshtë jepen karakteristikat dhe diagrama e çelikut të përdorur në strukturën tonë. Referuar eurokodeve shufrat e çelikut duhet të jenë patjetër të vjaskuara (çelik periodik),



Betoni

Bazuar te EC8, në strukturat me duktilitet mesatar DCM, nuk mund të përdoret per elementet paresore sizmike beton me klase me te vogel se C16/20.

1. Materjalet :

α . Beton	C30/37
β . Çelik	S-500
γ . Stafa	S-500

2. Koeficientet e sigurise se materialeve:

α . Betoni	$\gamma_c = 1,50$
β . Çeliku	$\gamma_s = 1,15$

3. Ngarkesat e perhershme:

Pesha vetjake e betonit C30/37:	24,00 kN/m ³
Pesha vetjake e ujit:	10,00 kN/m ³
Pesha vetjake e dheut:	20,00 kN/m ³

4. Ngarkesat e perkohshme:

Per hapsirat ujembajtese:	5,80 kN/m
---------------------------	-----------

4.1.4 Llogaritjet Hidraulike

LLOGARITJET HIDRAULIKE TE LINJES NGA ST.POMPAVE (Grapsh) NE REZERVUARIN
200m³

Te dhena:

$$q_{max}^{sek} = 30 \text{ l / sek}$$

$$L = 990 \text{ m}$$

Kota rezervuarit 200 m ³	H=434m
Kuota e kokes se pusit	H=224 m
Niveli dinamik i ujit ne pus	Hd=45m
Kuota e nivelit minimal te ujit ne pus	H =179m

per $q_{max}^{sek} = 30 \text{ l / sek}$, kemi :

Lartësia e ngritjes së ujit do të llogaritet për rastin më të disfavorshëm. Rasti më i disfavorshëm është rasti kur :

- në vaskë niveli i ujit ndodhet në nivelin minimal (dinamik)
- në rezervuar niveli i ujit ndodhet në nivelin maksimal .

Keshtu lartësia e kolones se ujit qe duhet te ngreje pompa eshte:

$$H_p = H_{gj} + h_w$$

ku: H_p – lartësia e ngritjes së ujit nga pompat

H_{GJ} – lartësia gjeodezike midis kuotës së nivelit minimal të ujit ($\nabla_{V.G.}^{N.DIN}$) në vaskën e grumbullimit (nga ku merret uji) dhe kuotës së nivelit maksimal të ujit ($\nabla_{REZ}^{N.MAKS}$) në rezervuarin rregullues (ku dërgohet uji).

h_w – humbjet hidraulike të linjës së jashtme, $h_w = h_w^{th} + h_w^d$ [m], ku përfshihen:

- a) **humbjet hidraulike në thithje** $h_w^{th} = h_{w_{gj}}^{th} + h_{w_v}^{th}$ [m]
(humbjet hidr. gjatësore ($h_{w_{gj}}^{th}$) dhe humbjet hidr. të vendit ($h_{w_v}^{th}$))
- b) **humbjet hidraulike në dërgim** $h_w^d = h_{w_{gj}}^d + h_{w_v}^d$ [m]
(humbjet hidr. gjatësore ($h_{w_{gj}}^d$) dhe humbjet hidr. të vendit ($h_{w_v}^d$))

Lartësia gjeodezike:
$$H_{GJ} = \nabla_{REZ}^{N.MAKS} - \nabla_{V.G.}^{N.DIN} = (\nabla_{REZ}^{TAB} + h_0) - (\nabla_{V.G.}^{TOKË} - h_d)$$

$$H_{gj} = 434 - 179 = 255 \text{ m}$$

- a) Humbjet hidraulike në thithje

$$hw^{th} = hw^{th}_{gj} + hw^{th}_v \text{ [m]}$$

Për të llogaritur humbjet hidraulike në thithje duhet të merren parasysh:

- pjerrësia hidraulike e rrjedhjes, e cila gjendet si funksion (qllog, vek). Nga tabela e tubacioneve prej çeliku nxirren të dhënat:

$$q_{max}^{sek} = 30 \text{ l / sek} \rightarrow \text{Tub Çeliku DN200mm} \rightarrow [i=0.00467\text{m/m} \\ v=0.88 \text{ m/s}$$

- koeficientët e humbjeve lokale në pajisjet e montuara në tubin e thithjes janë:

* Filtri me kundralvolvol $k_f = 10$

* Bërryli DN 200 mm 90° $k_b = 1.2$

Humbjet hidraulike në thithje janë:

$$hw^{th} = hw_{gj}^{th} + hw_v^{th} = [i^{th} \times l^{th}] + [(k_f + 2 \times k_b) \times \frac{v^2}{2 \times g}]$$

$$hw^{th}=0.70 \text{ [m]}$$

b) Llogaritja e humbjeve hidraulike në dërgim

$$hw^d = hw_{gj}^d + hw_v^d$$

Për të llogaritur humbjet hidraulike në dërgim duhet të merren parasysh:

- pjerrësia hidraulike e rrjedhjes, e cila gjendet si funksion (qllog, vek). Nga tabela e tubacioneve PE nxirren të dhënat:

$$q_{max}^{sek} = 30 \text{ l / sek} \rightarrow \text{Tub Çeliku DN250mm} \rightarrow [i=0.00156 \text{ m/m} \\ v=0.56 \text{ m/s}$$

koeficientët e humbjeve lokale në pajisjet e montuara në tubin e thithjes janë:

Kundralvola $k_k = 1.7 - 2$

Saraçineska (tip portë) $k_s = 0.03$

Bërryli DN 250 mm 90° $k_b = 1.2$

Degëzimi DN 250 mm $k_t = 1.0$

Humbjet hidraulike në dërgim janë:

$$hw^d = hw_{gj}^d + hw_v^d = [i^d \times l^d] + [(k_k + k_s + 2 \times k_b + k_t) \times \frac{v^2}{2 \times g}]$$

$$hw^d = 1.63 \text{ [m]}$$

Duke u bazuar në llogaritjet e mësipërme, llogaritet vlera e lartësisë së ngritjes së ujit nga pompa(t) (ndr. prevalenca e pompës):

$$H_p = H_{GJ} + h_w = H_{GJ} + (hw^{th} + hw^d) \text{ [m]}$$

$$H_p = 257.33 \text{ [m]}$$


Një pompë e impiantit me ngritje mekanike duhet të ketë parametrat hidraulikë:

$$q_{max}^{sek} = 30 \text{ l / sek}$$


$$H_p = 257.33 \text{ m}$$

Llogaritjet hidraulike per linjat e shperndarjes jane kryer me metoden e Hazen Willams duke perdorur Software-in WaterCad. Ashpersia e tubave do te perdoret ajo e tubave PE. Llogaritja do te behet duke patur parasysh ndryshimet orare te prujes per gjykuar me drejt per presionet maksimale gjate konsumit te ulet dhe presionet minimale gjate konsumit te larte ne rrjet.


Dimensionet e brendeshëm të tubave



Grafiku i presioneve në orën e pikut



Harta e presioneve ne oren e pikut



Nga rezultatet e llogaritjeve ne rrjetin shperndares, ka rezultuar e domosdoshme perdorimi i reduktoreve te presionit, pasi disnivele eshte i konsiderueshem nga depo deri ne piken fundore te rrjetit te brendshem.

Nder tipet e valvulave te presionit te disponueshme jane perzgjedhur ato me diafragme operimi. Dimensionimi i valvulave te presionit realizohet permes dy parametrave:

- Prurja e projektit
- Ruajtjen e nje raporti te presionit ne hyrje dhe ne dalje ≤ 2.5 me qellim mbrojtjen nga kavitacioni

Eshte gjithashtu norme gjate projektimit te reduktoreve qe te respektohet shpejtesia e rrjedhes si me poshte:

$$V = 0,7 \div 1,5 \text{ m/s (perdorim residenciale)} \quad V = 1 \div 3,5 \text{ m/s (perdorim industrial)}$$

DN mm	L mm	H mm	Portata min. m3/h	Portata max m3/h
50	200	166	0,5	40
80	200	200	5	60
100	302	230	30	150
150	390	314	50	300
200	385	350	50	350
250	535	445	80	800



Pra ne llogaritjet e rrjetit ku jemi perpjekur te ruajme nje presion

$H_{linë}=4-5\text{atm}$ ka qene e nevojshme instalimi edhe i me shume se nje reduktor presion ne menyre te njepasjeshme.

4.1.5 Tubacioneve te celikut ne linjen e transmetimit

- Tubacioni do te jete i izoluar nga brenda me llak –capitol “BLC” me trashesi prej 100 μ -300 μ , me rreshira epokside me trashesi prej 100 μ -300 μ (per uje te pijshem)
- Montimi te behet me saldim me elektroda
- Per tubat do te perdoret ekskluzivisht celik sipas standarteve te percaktuara nga Komuniteti European

Tubat do te jene ekskluzivisht te fabrikimit me tegel spiral

Vendet nga ku do te importohen tubacionet do te jene te certifikuara nga Komuniteti

European Veshja e jashtme ne vendet e lidhjes

Pjesa e jashtme e tubit prej celiku ne vendet e lidhjes midis tubave duhet te pregatitet me kujdes per veshje. Duhet te hiqen te gjitha papastertite ,pjeset e forta nepermjet nje furce metalike dhe me pas duhet te pastrohet me benzene.

Ne te gjitha rastet, nje kujdes i vecante do ti behet realizimit te saldimeve.

Nje veshje me mase bitumi dhe 2 shtresa me leter katrama me ngjitje ne nje temperature mbi 100 grade, do te vihet ne te gjitha pjeset e paveshura te tubacionit.

Bashkimi

Tubat prej celiku do te bashkohen me saldim. Saldimi do te realizohet sipas rregullave dhe kushteve teknike te zbatimit. Saldimi dhe prerja nepermjet flakes se elektrodes duhet te vertetoje me pelqimin e investitorit, se procedurat e aplikuara jane te njejta me Procedurat e saldimit standart.

Siperfaqet e saldimit nuk duhet te kene cifla, ndryshk, bojra ose trupa te tjere te huaj.

4.2 Pershkrimi i punimeve

4.2.1 Materialet per Tubat dhe Rakorderite

Tubat e polietilenit

Tubat do të jenë polietilen me desitet te larte, HDPE 100, per furnizim nentokesor me uje, në përputhje me EN 12201, EN DIN 8074, EN DIN 8075. Te gjithë tubat do te jene prodhuar nga material origjinal dhe jo me material te ricikluar. Karakteristikat e tubave do te jene: per HDPE 100 – Pn 10 SDR 17. Tubat duhet te shenohen lexueshem si ne vijim: Fabrika, numuri i regjistrimit, standarti per uje te pijshem, materiali sipas specifikimeve. Presioni nominal, dimesioni, Klasa (toleranca e diametrit OD), data e prodhimit, seria, numuri makinerise. Tubat qe nuk do te shenohen si me siper do te refuzohen. Tubat ne cdo kamion ngarkese do te shoqerohen me: Certifikaten e testit te materialit baze. Certifikaten e testit te tubit. Udhezimet e prodhuesit. Udhezimet e prodhuesit te tubove do të ndiqen në mënyrë rigoroze gjate ngjitjes.

